



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 396/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Murat Hoxha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha të subjektit politik LDK në Gjilan, me të cilën pretendohet se në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) në QV 0402D/08R nuk shihet numri i votave gjithsej 55.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitë ka bashkangjitur si provë kopjen e FRK-së dhe raportin e vëzhguesve .

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet Murat Hoxha nga subjekti politik LDK, në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidati në fjalë pretendon se në FRK e QV 0402D/08R nuk shihen numri i votave të tij.

PZAP-i, ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR se për kandidatin në fjalë me nr. 31 nga radhët e LDK-se Murat Hoxha, rezultojnë se i posedon 55 vota dhe se numri i këtyre votave është proceduar ne rezultatin përfundimtar te dhëne nga QNR-KQZ, prandaj pretendimet ankimore lidhur me mungesën e votave në FRK-në e VV-së 0408d/03R nuk qëndrojnë.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 396/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*